



**BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVES
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA**

Rregullat dhe Procedurat Operuese

Të Sistemit Elektronik i Kliringut Ndërbankar dhe Shlyerjëve

Njohtim: SEKN është sistemi elektronik i kliringut dhe rregullimit (shlyerjes) për urdhëresë pagesa (kredit transfere) ndërmjet bankave dhe BPK – së si agjent i MEF (ish Autoritetit Qendror Fiskal) në Kosovë. Ky shërbim ofron setëlmentin një herë në ditë të Netos në llogaritë e BPK –së për urdhëresa të veqanta/ ose sasisë së letrave të listave të urdhëresave të shumëfishta sikur që janë pagesat masive të pagesave. Shërbimi është i kufizuar në shkëmbimin e të dhenave elektronike - nepërmes rrjetit të lidhjeve permanente të siguruara nga PTK përmes modemeve të zyrës së kliringut në BPK.

Autorizuar në bazë të nenit 9 të Rregullës XVIII mbi Kliringun dhe veprimin e llogarive rregulluese si dhe sipas Rregullorës së UNMIK Nr. 2001/26, BPK ka krijuar Sistemin e Kliringut Qendror Ndërbankar si shërbim I kliringut elektronik i nivelit të regjistrimit dhe rregullimit për urdhëresë pagesa ndërmjet bankave dhe BPK – së si agjent i Organeve Qeveritare në Kosovë. Ky shërbim ofron rregullimin një herë në ditë të Netos në llogaritë e BPK – së për urdhëresa të veçanta ose sasisë së letrave të urdhëresave të shumëfishta sikur që janë pagesat e pagave përmes llogarive bankare. Shërbimi është i kufizuar në shkëmbimin e të dhënave elektronike - nepërmes rrjetit të lidhjeve telefonike (lease lines) të Zyrës së Kliringut të BPK-së.

Rregullat Operuese të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar dhe Shërbimit të Shlyerjës

1.0 Pasqyrë e përgjithshme

1.1 Qëllimi

Sipas paragrafit 5 të rregullores Nr. 1999/20, një prej qëllimeve themelore të BPK – së është që të kujdeset për një sistem efikas dhe të sigurt të pagesave vendase. Sipas paragrafit 39, BPK mund të organizoi, zotëroi dhe vë në veprim sistemet për kliring dhe rregullim të pagesave ndërbankare. Sipas rregullës së UNMIK-ut Nr.2001/26 është ligji i pagesave dhe transaksioneve të Kosovës (PTLK).

Prandaj, qëllimi i rregullave dhe I procedurave vepruese është që të përshkruaj procedurat që duhet të zbatohen nga bankat që participojnë në SKN (ICS). Këto rregulla zbatohen tek të gjitha transaksionet e bëra nëpërmjet SKN dhe sipas marrëveshjes së lidhur sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovës me secilën bankë që dërgon urdhëresëpagesë drejtëpërsëdrejti në BPK, pastaj secila bankë që pranon urdhëresëpagesë drejtëpërsëdrejti nga BPK – ja dhe cilido përfitues që kreditohet sipas urdhëresëpagesës së llogarisë të mbajtur apo të përdorur në BPK. Përveq kësaj, rregullat janë të lidhura me ndonjë palë tjetër në transaksion, ku ndonjë pjesë e të cilit ka kaluar nëpërmes të SKN –së.

1.2 Fusha e veprimtarisë

Në Sistemin e rregullimit të kliringut elektronik, rregullimi (setelmenti) bëhet individualisht në urdhër pagesë në bazë të urdhër pagesës për pagesat prioritare siç janë pranuar ose në fund të ditës për pagesat e pranuar në bazë të dosjes në librat e BPK – së. Shërbimi që duhet paguar dhe lista e taksave të aplikueshme gjenden në paragrafin 9. Struktura e taksave e dizajnuar për mbulimin e çmimeve të BPK- së në një afat më të gjatë mund të ndryshohet kohë pas kohe. çdo ndryshim do të paraprihet me një publikim nga ana e BPK _ së.

1.3 Përgjegjësia e BPK – së

BPK udhëheqë shërbimin për të gjitha bankat që mbajnë llogaritë shlyerëse

në BPK dhe kanë nënshkruar marrëveshjen e kërkuar që është konform me standardet e shërbimit në pajtim me (PTLK-ligjin e pagesave të Kosoves). BPK –ës lëshon, publikon dhe shpërndan rregullat si dhe rregullon standardet për qeverisjen e këtij shërbimi.

Strukturat Shifrat, stru, shifrat strukturat dhe taksat e aplikuara të SKNsherbimit munde te ndryshohen kohe pas kohe nga BPK – ja.

Modifikimet e tilla të bëra shërbimit do të jenë të paraprirra nga komenti publik dhe publikimi i mehershem. Poashtu BPK – në mënyrë gjenerale sistematikisht do të konsultohet me bankat para se të bëhet ndonjë ndryshim në rregulla.

1.4 Përgjegjësia e pjesëmarrësve

Është përgjegjesi e bankës që është kualifikuar me licensë prej Departamentit të Mbikqyrjes së Bankave dhe është pajtuar që të merr pjese në ICS që të vëzhgoj rregullat e parashtruara nga BPK – ja.

Përghithësisht, disa anëtarë që veprojnë brenda kapacitetit si pjesë e tretë e metodës për organizatat tjera, bartin gjithashtu të drejtat e njëjta, dhe /ose kërkojnë të njëjtat obligime nga këto palë që kanë të bëjnë me participimin e tyre.

Pjesëmarrësit në ICS janë përgjegjës për menaxhimin e statusit të llogarive të tyre të rregullimit, duke mbajtur gjithmonë fonde të mjaftueshme për të paguar për secilin transaksion ose fajl që është derguar nepërmes shërbimit. Pjesëmarrësit mund të plotësojnë llogaritë e tyre shlyrëse sipas nevojës duke pranuar urdhër pagesa nga pjesëmarrësit tjerë, duke blerë fonde nga bankat tjera, (treg ndërbankar) ose duke shitur mjete. Pjesëmarrësit duhet të kuptojnë se me bilanc jo – adekuat të llogarisë shlyrëse mund të rezultojë deri të refuzimi i urdhër pagesave.

2.0 Rregullat Bazike – Procesimi i transaksioneve

2.1 Definicioni i termeve⁷

Ky dokument i parashtron definicionet e termeve në vijim dhe i vrojton të gjitha definicionet e themeluara

- *Pjesëmarrës* do të thotë banka që mbanë llogari shlyrëse në BPK, dhe që pajtohet me shkrim që të i'u përmbahet Rregullave të shërbimit; BPK- ja vepron në emër të Autoritetit Qendror Fiskal të Kosovës me qëllim të udhëheqjes së funksionit të agjensisë fiskale përmes ICS.

⁷(Termet e përfshira në paragraf duhet të definojnë në pajtim me rregulloren NR.2001() të UNMIK – ut për transaksionin e pagesave, kur shpallen)

- *Media* do të thotë forma e përfshirjes së transaksionit në EICS; media mund të jetë në letër ose në formë elektronike, d.m.th. transmetim ditor.
- *Barazimi dhe shlyerja (Clearing)* do të thotë zgjidhja elektronike apo edhe fizike e transaksioneve që bëhet nga BPK – ja sipas rregullimit në librat e BPK – së;
- *Me Standarde* nënkuptohen formatet, kodet identifikuese të bankës, dhe specifikacione tjera teknike të caktuara nga BPK – ja për të pranuar urdhër pagesat.

2.2 Qëllimi i pagesave

Pagesat e procesuara nga BPK – ë s përmes shërbimit të SKN mund të jenë për një rën nga këto dy qëllime:

1) Transferi ndërbankar përdoret për të lëvizur paratë në mes të institucioneve financiare për llogaritë e tyre. Banka zakonisht përdor transfere të tilla kur i huazon para ndonjë banke tjetër (tregu ndërbankar) ose kur e përshtat llogarinë e vet me bankën korrespondente.

2) Transferi i palës së tretë përdoret për ti paguar obligimet në mes të klientëve të institucionit financiar. Transferet e tilla do të përfshijnë numra standard të llogarive për të identifikuar paguesin (dërguesin) dhe pagëmarrësin (përfituesin), dhe informata në lidhje me qëllimin e pagesës.

2.3 Nivelet e shërbimit

SKN vlenë vetëm për urdhër pagesat vendase (transferet e kredive) në mes të zyrave qendrore të bankave të licensuara. Transferet në mes të filialave të bankës së njëjtë nuk pranohen. Transaksionet e tilla (ne - përdorim) duhet të zhvillohen brenda sistemit të kontabilitetit të bankës pjesëmarrëse.

2.4 Llojet e transaksioneve

Vetëm një lloj bazik i transaksionit mund të regjistrohet në SKN - urdhër pagesa. Urdhërat përgatiten nga bankat urdheruese si regjistrime të vetme, pagesa prioritare, ose fajlet elektronike (transmetime të të dhënave apo informative) të identifikuar nga numri standard identifikues i bankës pranuese.

2.5 Disponueshmëria e Fondeve

Të gjitha transaksionet që regjistrohen në ICS përfaqsojnë debitë e menjëherëshme në llogaritë e klientëve nga bankat urdheruese, mirëpo kreditë nga BPK – ja tek BP (banka pranues) për tërheqjet e parave të gatëshme të klientit, deri në mëngjesin e ditës pas setelmentit në llogaritë e BPK- së. BPK do të informoi bankat pranuese gjat ditës deri sa mjetet do të jenë ne disponim për pagesat prioritare Në rast të mos disponimit me fonde të mjaftueshme në llogaritë e Bankës urdheruese për ti mbuluar transferet në kohën e regjistrimit në ICS pagesat do të refuzohen dhe kthehen asaj banke.

2.6 Orari i shërbimit

Së paku një here në vit, BPK do të publikojë orarin e orëve operuese për shërbimin e SKN (paragrafi 8.0). Shërbimi është në dispozicion gjatë të gjitha ditëve të punës; me përjashtim të ndonjë feste kombëtare apo të bankës. Orët e shërbimit janë prej 8.00 – 14,30, nëse nuk është përmendur e kundërta në separatet e publikuara nga BPK. Në rrethana të jashtëzakonshme, orët e punës mund të zgjerohen në rast të ndonjë kërkesë specifike nga ndonjë pjesëmarrës.

3.0. Procedurat Standarde

3.1 Bankat urdhëruese dhe pranues, BPK (në vazhdim si bashkangjitje 3.0 . I)

4.0 Rregullat themelore për rregullim dhe udhëheqje të rrezikut

4.1 Rreziku i definuar (gjenerik)

SKN, siq është edhe rasti me të gjitha shlyerjet dhe barazimet e rregulluara e përmban rrezikun e ekzekutimit të pasuksesëshëm për shkak të një dështimi financiar apo operacional. Ekspozimi ndaj rrezikut është definuar dhe masat përkatëse janë të përshkruara në kete paragraf, për të parandaluar apo kundërvepruar ndaj dështimeve potenciale. SKN duhet të balafaqohet me rrezikun financiar qoftë kredit, shlyerje ose rrezik operacional ose sistemik , qoftë ai i kontrolluar apo i pakontrolluar.

“ Kredit rreziku” është një “rrezik që shkaktohet kur një kundërpalë në një transaksion nuk do ta kryej obligimin për vlerën e plotë, për më tepër edhe atëherë kur duhet.”⁸

⁴ *Shiko fjalorthin e Sistemit te Pagesave ne grupin e dhjete shteteve (Basle, Banka per Setelment Nderkombetare, Dhjetor, f.536*

Bankat ose Klientet e Bankave që huazojnë fonde ne procesin e pagesave mundë të mos jenë në gjendje që të ripaguajnë ato fonde për arsye të cilat mundë të mos kenë lidhje me aktivitetet e pagesave. “Kredit rreziku” në sistemin e pagesave mundë të jetë në mënyrë të afërt i shoqëruar me kushtet e përgjithshme të kreditit në tregun bankar dhe financiar dhe shpesh është shkak kryesor i rrezikut të likuiditetit. BPK do të monitorojë ekspozimin potencial ndaj kësaj forme të rrezikut, në nivelin më të lartë nëpërmjet Departamentit të saj për Mbikqyrje Bankare.

“Rreziku i likuiditetit” është një rrezik kur një kundërpalë (apo pjesëmarrës në sistemin e kliringut dhe shlyerjes) nuk do të zbatojë obligimin për vlerën e plotë kur ajo duhet. Rreziku i likuiditetit nuk nënkupton atë që një kundërpalë apo pjesëmarrës është i falimentuar përderisa ai mundë të jetë në gjendje që të rregulloj obligimet e debitit të kërkuar në disa kohë të paspecifikuara andej e tutje.”⁵ BPK do të monitorojë ekspozimin potencial ndaj kësaj forme të rrezikut përmes Departamentit të saj për Mbikqyrje Bankare, apo përmes proceseve të saja të brendshme të rishqyrtimit, dhe munde që të bëjë thirrje për masat e ndermarra që ta kontrollojë atë në baza rast pas rasti.

“Rreziku sistemik” është ai “rrezik i dështimit te nje pjesemarresit ne transfer apo në treg financiar në përgjithësi, që ti përmbush të gjitha obligimet e kërkuara do të rezultojë që pjesëmarrësit e tjerë apo institucionet e tjera të mos jenë në gjendje që ti përmbushin obligimet e tyre (duke përfshirë edhe setelmentin në sistemin e pagesave) atëherë kur duhet. Një dështim i tillë mundë të shkaktojë probleme signifikante në likuiditet apo probleme në kredi dhe si rrjedhojë mundë të kërcënojnë stabilitetin e tregjeve financiare.”¹⁰

Rreziku sistemik mundë të rezultojë nga zgjerimi i kreditit ndërmjet bankave në procesin e pagesave ose në tregjet ndërbankare. BPK – ja do të monitorojë këtë formë të rrezikut dhe mundë të bëjë thirrje për masa operationale dhe prudenciale për ta kontrolluar atë.

“Rreziku i kontrolluar operacional” është rreziku kur pajisjet përcjellëse, sistemet dhe rregullat brenda përgjegjësisë se ndonjë pjesëmarrësi të veqantë do të dështojnë së funksionuari si duhet që të kryhet obligimi i pagesës. Shkaktari i njohur i rrezikut te ketille duhet të identifikohet dhe

të merren masa paraprake kundervepruese nga pjesëmarrësi dhe BPK – ja. BPK do të kujdeset për planet operationale të rastit për funksionimin e vazhduar dhe prej bankave pjesëmarrëse poashtu pritet të ndërmarrin hapa të njëjtë që të zvogëlojnë efektin e dështimit në institucionet dhe klientë të tyre.

4.2 Monitorimi dhe kontrollimi i ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të shlyerjes

Qdo pjesëmarrës në SKN do ta ketë një llogari për shlyerje (setëlment) në BPK për aktivitetet e pagesave. Në Kosovë, Bankat pjesëmarrëse pritet që të mbajnë një balancë të mjaftueshëm në atë llogari që të paguajnë për transferet që urdherohen. Llogaria e shlyerjes ndodhë që nuk është në qdo kohe e stërngarkuar. Balanci në llogari mundë të ngritet nga urdhër pagesat e pranuar apo nga transferet ndërbankare.

⁵ *Ibid, f. 537*

⁶ *Ibid, f. 537*

BPK do të pranojë apo refuzojë urdhërpagesat bazuar në atë se a ekzistojnë fonde adekuate në llogari që të mbulohet urdhërpagesa.

Ekstraktet ditore të aktivitetit në llogarite setëlment do të pasqyrohen dhe të jenë në dispozicion për tu marrë nga korieri. Bankat priten që të pajtojnë transaksionet me shenimet e tyre interne dhe të raportojnë ndonjë ndryshim tek BPK – ja menjëherë.

5.0 Standardet e Sistemit të Kliringut ndërbankar

5.1 Urdhër pagesat (shtojca 2)

Transaksioni themelor Brenda SKN është urdhër pagesa. Cdo urdhëresë përfaqëson nga një transaksion të vetëm. Format i urdhëresës është standard për të gjitha transaksionet dhe është i treguar në shtojcën 2.

Elementet e të dhënave vijuese duhet të përfshihen në dosjet e urdhër pagesave:

- Banka urdhëruese (BU) numri identifikues standard i bankës¹¹
- Bankë Pranuese (BP) numri identifikues standard i bankës
- Shuma e urdhëruar
- Numri i llogarisë së klientit urdhërues duke përdorur strukturën standarde të llogarisë
- Numri i llogarisë së klientit përfitues duke përdorur strukturën standarde të llogarisë
- Data e urdhëresë pagesës apo dosjes (e sotshme nëse është regjistruar sot)
- Referenca apo numri kontrollues, e future nga OB – ja.

5.2 Standardet uniformë

Standardet e ICS janë të ndërtuara sipas standardeve ndërkombëtare⁸. BPK – ja i mbanë të gjitha standardet e ICS duke i publikuar dhe shpërndarë revisionet për pjesëmarrësit sipas nevojës për ti akomoduar kushtet e ndryshimit. BPK – ja gjithashtu mbanë një Direktorium të

Numrave Identifikues Bankar duke publikuar dhe shpërndarë revisionet sipas statusit të bankave ose bashkimit të bankave gjatë një kohe.

6.0 Detyrimet dhe Marrëveshjet

6.1. Detyrimet e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave

Me ofrimin e SKN, BPK vepron vetëm si agjent i pronarit të llogarisë rregulluese (setelment) në lidhje me çdo pagesë. Ky ndërmjetim merr fundë jo më vonë se kur BPK – ja pranon pagesën për formularin në fonde duke debituar llogarinë setelment të pjesëmarrësit dergues. BPK – ja nuk mund të ketë ose marrë asnjë detyrim sa i përket një formulari ose shumës së saj të mirë ose dështimit për të ushtruar kujdes të zakonshëm.

BPK – ja mund të prezentoj ose dërgojë një pagesë në bazë të numrit identifikues të bankës ose ndonjë emërtimi tjetër të RB (bankës pranues) që paraqitet në ndonjë formë në pagesë kur është pranuar për procesim. BPK – ja nuk do të jetë përgjegjëse për qfardo vonese që rezultojn nga veprimi i saj i bazuar në atë emërtim.

BPK – ja ka të drejtë që të kërkojë mekembjen e qfaredo shume të paguar për ndonjë kërkesë kontestuese përmes kanaleve të ligjit që aplikohet në Kosovë.

6.2. Marrëveshjet ligjore

Marrëveshjet me shkrim i mbulojnë të gjitha fazat e operacioneve të SKN në mes të BPK – së dhe bankave pjesëmarrëse (Shtojca IV).

7.0 Amandamenti

Procedurat operuese mund të ndryshohen në çdo kohë nga BPK.

8.0 Orët e punës – Orari

8.1 Ora e hapjes

BPK – ja pranon transfere të fondeve të pranueshme duke filluar që nga ora 8.00 çdo ditë pune. Në rrethana të pazakonshme, dhe në liri veprimi të BPK – së , pagesat mund të pranohen edhe para kësaj kohe.

8.2 Ora e mbylljes

BPK – ja pranon transfere vendase të fondeve të pranueshme deri në ora 15,30 çdo ditë pune. Në rrethana të pazakonshme, dhe në liri veprimi të BPK – së , pagesat mund të pranohen edhe pas kësaj kohe.

⁷ BIC poashtu i njohur si kodi SËIFT identifikon bankat siq është definuar në standardin ISO 9362.

⁸ Komiteti Evropian për Standardet Bankare, "Standardet për transfer kredit" # 207, Mars, 1998 dhe "Standardet për Numrat e Llogarisë së Bankave", # 204, Nëntor, 1996,

" Udhërrfyesi për implementimin e IBAN", # ECBS SIG 203; dhe "Regjistri i numrave të llogarive Evropiane", ECBS#201; SËIFT Standardi i fajl transferit # _____

8.3 Ditët e punës

BPK – ja pranon transferin e pranueshëm të fondeve në të gjitha ditët me përjashtim të festave standarde të caktuara nga FRY e Kosovës.

- Të gjitha të Shtunat
- Të gjitha të Dielët
- -----
- -----

8.4. Tabela e provizioneve të SKN (bashkangjitur)

shtojca I

Procedurat standarde për bankat urdhëruese dhe përfituese

1. Detyrat e Bankes Urdhëruese

1.1 Autorizimi dhe identifikimi i deponimeve

Të gjitha urdhëresat dhe grupi I pagesave (fajllat) duhet të përmbajnë datën e dërgimit dhe origjinimit të numrave identifikues të bankave.

1.2 Përgaditja e deponimeve ne menyre te sakte

Secili pjesëmarrës duhet që të përgatisë një formë elektronike, ku duhet të jepet vlera totale e urdhëresave për secilin pjesëmarrës tjetër në Kliring dhe në formën transmetuese të përshkruar Fajllat e transmetuar me lidhje telekomunikuese duhet që të jetë në pajtim me standardet e BPK-së të krijuara për atë qëllim. Në rast të pengesave në linja komunikuese, banka që gjeneron fajllin duhet që të sigurojë një alternativë që siguron pranim pa vonesë në BPK siç është treguar në 1.3 më poshtë.

1.3 . Dërgesa

- Mënyra elektronike e dërgimit

Urdhëresat duhet të sjellen në mënyrë elektronike ne kliring ne ose para orës se caktuar per çdo ditë pune. Dërgesat që pranohen pas kohës së përshkruar do të refuzohen nga BPK nëse para kësaj nuk ka pasë marrëveshje me bankën origjinuese

1.4 Gabimet gjatë punës – Dita e Sotme

Procdurat në vijim aplikohen ndaj gabimeve gjat procesimit në ditën e pranimit në vet BPK:

- Banka duhet menjëhere të njoftoi BPK – nese zbulon apo ndëgjon, pamvareisht nga cili burim mundësinë e ndonjë gabimi, prishjen e sigurisë, ose mungesën e autoritetit në përpunimin e urdheresë pagesesës.
- Nese BPK –ja perpunon nje urdherese pagease ne nje shume ndryshe nga ajo e cila eshte urdheruar fillimisht, BPK –ja do te beje pershtatjen e regjistrimeve ne llogarite e te dy bankave asaj urdheruese dhe perfituese, nese keshtu pajtohen bankat;

- Nese BPK – ja perpunon nje urdherese pagese dy here, ajo duhet ti pershtate llogarite e te dy bankave, urdheruese dhe perfituese, nese keshtu pajtohen bankat;
- Bankat pranuese duhet qe te gjejne dhe te kthejne urdheresat me gabime qe kalojne shumën 10,000 € ka mundësi edhe deri në ora 15:30 të ditës kur kryhet kliringu (apo me se largu ditën e nesërme për te gjitha shumat e origjinuara gabim)).

1.5 Gabimet gjatë punës – Dita e mëparshme

Ne raste se zbulohen gabimet ne perpunimin e urdherese pagesave qofte nga banka urdheruese apo perfituese pas dates se setelmentit, dhe se BPK – ja nuk eshte pergjegjese per gabimin, BPK – ja do te beje qmos qe te zgjidh problemin me palet e involvuara. Nga bankat kerkohet qe ti mbajne provat e plota te revizionit si dhe dokumente plotesuese si evidence per kerkesat e tyre per harmonizim. Megjithate, BPK – ja ne asnje rast nuk do te merr asnje gabim i cili i prezentohet asaj pas kalimit prej 30 ditesh kalendarike ndryshe nga data e setelmentit te pagesës.

1.6 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Ne raste se gabimet ne perpunimin e pagesave nuk munde te zgjidhen me BPK – ne si ndermjetesuese ne mes paleve, apo nese transaksioni nuk zgjidhe obligimin themelor ne mes debitorit dhe kreditorit, kontesti do ti lihet bankave pjesemarrese qe ta zgjedhin ate duke përdorur qfardo mjete qe ata mund të kenë në dispozicion përmes mjeteve tjera jashtë kanaleve bankare.

2.0 Detyrat e Bankës përfituese

2.1 Vërtetimi i pranimi

Secila bankë përfituese do të konfirmojë në mënyrë elektronike si një pranim të marrëveshjes me një shumë me një shumë që do të debitohet apo kreditohet në dhe të barazohen llogaritë si rezultat i sesionit të kliringut.

2.2 Marrëveshja për ose Kthimin e Pagesave

Pagesat mbeten pronë e bankës urdhëruese derisa ato të rregullohen ose të kthehen. Bankat përfituese i mbajnë pagesat në besim derisa ato të kreditojnë llogarinë e përfituesit në librat e tij.

2.3 Kthimi i menjëhershëm i pagesave të gabueshme

Përveç siç është specifikuar në 1.4 më lartë. Urdhëresëpagesat e dërguara ose të pregaditura gabimisht duhen pajtjetër ti kthehen Bankes urdhëruese nëpërmjet SKN, në sesionin e ardhshëm të **Bankës Kliring**.

3.0. Detyrat e BPK – së

3.1. Të përgjithshme

BPK – ja është pjesëmarrëse e Bankës Kliring dhe ajo mund të pranojë dhe dërgoi urdhëresat në të njëjtën shkallë sikur edhe qdo pjesëmarrës tjetër dhe do të veprojë asisoji në emër të (Autoritetit Qendror Fiskal) organeve qeveritare sipas kërkesës. Përveç tjerash, BPK – ja do të siguroi lokalet për mbledhjet e bankës kliring dhe ti barazoi llogaritë në librat e saja për pjesëmarrësit. Gjatë kryerjes se funksioneve të saja, banka duhet ti respektoi provizionet vijuese.

3.2 Përgaditja e Formularëve

Menaxheri i Sistemit të Kliringut Ndërbankar në BPK do të llogaris obligimet neto të shlyerjes duke i përfshirë shënimet elektronike të shlyerjes nga pjesëmarrësi në bazën e të dhënave të rregullimit(setelmentit).

3.3. Rregullimi

Rregullimi I pagesave do të kryhet në çdo dite pune duke debituar ose kredituar llogarinë për pagesë që mbahet nga pjesëmarrësit në BPK. Kur shuma e përgjithshme e urdhëresëpagesave të prezentuara tejkalon shumën e përgjithshme të pranuar, llogaria e pjesëmarrësit do të debitohet ICS 006 (Shtojca IX). Kur shuma e përgjithshme e urdhëresëpagesave të pranuar tejkalon shumën e përgjithshme të prezentuar, llogaria e pjesëmarrësit do të kreditohet ICS 005 (Shtojca VIII). Kur Menagjeri i SKN në BPK të ketë balansuar rezultatet e shlyerjes e për pagesën e kliringut dhe do të shkruhet elektronikisht debi apo kredia për atë pjesëmarrës që ka llogari në kliring Për pagesa prioritare shlyerja do të paraqitet sikur transaksionet janë kryer nëpër BPK.

3.5 Regjistrimi i të dhënave në librat e BPK- së

Kur kalkulimet e bankës kliring të jenë të përfunduara, Drejtori I SKN në BPK do të përgadis një njohtim elektronik për secilën bankë për tu procesuar në bankën në llogari të shlyerjes

Letër Pëlqimi

Autoriteti Bankar dhe Pagesave të Kosovës

-----,-----

Ne pajtohemi me dispozitat e Rregullave të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar dhe të Shlyerjes (Setelmentit) (EICS), me shtojcat, bashkangjitjet si dhe ndryshimet që mund të bëhen kohë pas kohe. Kjo bank është e licensuar nga BPK-ja. Për më tutje, në dërgimin e urdhërpagesave përmes SKN-së, ne pajtohemi që të ndjekim standardet e njëjta dhe të adoptuara nga BPK-ja.

Data: _____

Emri i Bankes: _____

Adresa: _____

Nr. identifikues i Bankës: _____

Nga: _____

Titulli: _____

Procedurat Ditore të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar

KOHA	Bankat Pjesëmarrëse në SKN	Sistemi i Kliringut Ndërbankardhe Shlyerjet ne Llogari në BPK	Vërejtje tjera
8:00 8.00 - 8.30	<ul style="list-style-type: none"> Banka pranon raportin mbi gjendjen e llogarisë në BPK 	<ul style="list-style-type: none"> Fillimi I punës Operimet në system dhe kontrollat rutinore Verifikimet e fundit të dites paraprake dhe kontrollat e back-up te ditës paraprake 	
8:30-10.30	Banka monitoron gjendjen e saj te llogarisë dhe përgatitet për pranimin e transferetave te kreditit nga degët dhe nëndegët. Ora 9.30-10 te gjitha pagesat e pranua nga SKN normale nga dita paraprake kreditohen llogaritë e klientëve (kufiri)	<ul style="list-style-type: none"> Kontrollimi I gjendjeve te llogarisë se bankave pjesëmarrëse dhe azhurimet në lloagritë operacionale në SKN Informimi I bankave mbi balancat ekzistuese Dërgimi I fajlave për klient te SKN (shrytëzues të mass modulit) per jopjesmarrës direct te SKN) përmes FTP programit për KPST dhe ATK (flash disk, internet, FTP program) 	Banak duhet te siguron shlyerjet ne lloagri, te kreditohen te gjithë llogaritë e klientëve pranues, me së largu deri ne ora 10.00
prej 10:30 deri 14:30	Bankat komerciale pranojnë informatat permes SKN mbi kreditet apo dergojnë pagesa (debitet)	<ul style="list-style-type: none"> Kliringu dhe shlyerjet për pagesa prioritare një nga një Monitorim, kontrollë e gjendjes se llogarisë dhe pozitive të likuiditetit. 	Nëse banka komerciale nuk ka fonde te mjaftuara SKN duhet te njofton fillimisht ate qe te siguron ato. Ne rast rreziku lajmron menjëherë mbikqyrjen bankare
prej 14:30	Banak komerciale fillon azhurimet dhe kontrollimete pagesave gjatë dites. Bene futjen e te dhenave ne SKN	<ul style="list-style-type: none"> Informata per banken sipas nevojës mbi balncat ne llogari dhe shlyerjet 	

15:00 15.30(prerje e kohes),	Banka dërgon pagesat për kliring dhe shlyerje ne SKN -----	<ul style="list-style-type: none"> • Pranimi I fajlave për pagesat normale të dërguara përmes sesionit të kliringut • Kontrolla rutinë, verifikimi dhe autorizimi I pagesave per bankat ku janë dedikuar 	Banakt komerciale marrin fajlat elektronik te transfereve
Deri ne 16:00		<ul style="list-style-type: none"> • SKN bënë urdhëresat për regjistrim ne llogari ne baza neto (debit ose kredit per llogaritë e bankave) • Kontrollon dhe verifikon raportet e konsoliduara dhe urdhërtransfereve detale 	Nese paraqitet ndonje problem vendoset me amrrëveshje te dyanshëme apo nag te gjitha palet e involvuara dhe ne pajtim me procedura
16:00	Banka komerciale pranon, kontrollon dhe verifikon të dhenat e marra mbi pagesat normale nga BPK dhe të gjitha bankat tjera Kontrollon ato dhe ne rast te nevojës kontakton SKN per ndonjë gabim apo tjera	<ul style="list-style-type: none"> • SKN kontrollon konfirmimet e bankave mbi pranimin e rregullt të pagesave. • Bëhet përgatitja e urdhëresave për shlyerje ne llogari ne baza NETO. 	
Prej 16:15	Banak komerciale përshtatë llogaritë për pagesat e pranuar dhe dërgon konfirmimin elektronik në BPK për pranim (automatik modul)	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e gjendjes faktike pas shlyerjeve elektronike dhe rexhistimeve ne llogari. • Pergatitja e raporteve ICS 01, ICS 02 dhe ICS 03 	
<u>17:00</u>	-	<ul style="list-style-type: none"> • <u>Fundi I ditës</u> 	